

Samiti BE-Ballkani Perëndimor

Deklarata e Brukselit, 17 dhjetor 2025

Ne, udhëheqësit e Bashkimit Evropian (BE) dhe të shteteve anëtare të tij, në konsultim me partnerët tanë të Ballkanit Perëndimor, arritëm sot në konkluzionin e mëposhtëm:

1. Samiti i sotëm shërben si dëshmi e themeleve të forta të marrëdhënies sonë dhe përfitimeve që ajo sjell për qytetarët tanë. Agresioni rus kundër Ukrainës dhe sfidat gjeopolitike në intensifikim nxjerrin në pah nevojën për lidhje **gjithnjë e më të forta midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor**. Samiti është rasti më i rëndësishëm gjatë vitit për të rikonfirmuar partneritetin strategjik midis Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor.
2. **Ne rikonfirmojmë angazhimin tonë të plotë dhe të qartë ndaj perspektivës së Ballkanit Perëndimor për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. E ardhmja e Ballkanit Perëndimor qëndron në Bashkimin tonë.** Zgjerimi është një mundësi realiste, të cilën duhet ta shfrytëzojmë.
3. Mirëpresim **energjitë e reja dhe progresin e bërë që prej samitit të fundit**. Përshpejtimi i procesit të anëtarësimit, bazuar në reformat e besueshme të partnerëve, kushtëzimin e drejtë dhe rigoroz dhe parimin e meritave të veta, është në interesin tonë të përbashkët.
4. Zgjerimi është një **investim gjeostrategjik në paqe, siguri, stabilitet dhe prosperitet**, siç thuhet në Deklaratën e Granadës. Urgjencat e kohës sonë kërkojnë një vrull të qëndrueshëm. **Anëtarët aspirantë duhet të intensifikojnë përpjekjet e tyre për reforma. Në të njëjtën kohë, Bashkimi Evropian duhet të intensifikojë punën në terren dhe reformat e tij të brendshme.**
5. BE-ja mirëpret **angazhimin e partnerëve të Ballkanit Perëndimor në mbështetjen e vlerave dhe parimeve evropiane, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe duke u dhënë prioritet parimeve të demokracisë, të drejtave dhe vlerave themelore dhe shtetit të së drejtës**, si dhe pret që ata ta demonstrojnë këtë si me fjalë ashtu edhe me veprime duke marrë përsipër dhe duke zbatuar reformat e nevojshme, veçanërisht në fushat kryesore. Liria e shprehjes, media e pavarur dhe pluraliste, barazia gjinore dhe roli i fuqishëm i shoqërisë civile janë vendimtarë për të garantuar funksionimin e demokracisë. BE-ja u bën gjithashtu thirrje partnerëve të garantojnë të drejtat dhe trajtimin e barabartë të personave që u përkasin pakicave.

6. **Bashkëpunimi gjithëpërfshirës rajonal, pajtimi dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë** mbeten çelësi për ndërtimin e një të ardhmeje të përbashkët dhe për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në mirëbesim dhe me rezultate të prekshme, duke përfshirë Marrëveshjen e Prespës me Greqinë dhe Traktatin për Miqësinë, Fqinjësinë e Mirë e Bashkëpunimin me Bullgarinë. Nevojiten ende përpjekje të mëtejshme dhe vendimtare për të nxitur pajtimin dhe stabilitetin në rajon, si dhe për të gjetur dhe zbatuar zgjidhje përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe detyruese për mosmarrëveshjet dhe problematikat rajonale dhe dypalëshe të partnerëve të rrënjësura në trashëgiminë e së kaluarës, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe parimet e vendosura, ku përfshihen Marrëveshja për Çështjet e Trashëgimisë, rastet e mbetura të personave të zhdukur dhe çështjet e krimeve të luftës.
7. **Ne qëndrojmë të bashkuar në mbështetjen tonë të palëkundur dhe solidaritetin me Ukrainën**, pasi ajo mbron sovranitetin dhe integritetin e saj territorial kundër luftës së paprovokuar dhe të paligjshme të agresionit të Rusisë. Ne përsërisim mbështetjen tonë për një paqe gjithëpërfshirëse, të drejtë dhe të qëndrueshme në Ukrainë, bazuar në Kartën e OKB-së dhe të drejtën ndërkombëtare. Ne do të vazhdojmë të investojmë në qasjen shumëpalëshe dhe të bashkëpunojmë me partnerët për të respektuar të drejtën ndërkombëtare.
8. Harmonizimi me **Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (CFSP) të BE-së**, duke përfshirë futjen në fuqi dhe zbatimin e masave kufizuese të BE-së dhe parandalimin e anashkalimit të tyre, mbetet një shprehje e fortë e zgjedhjes strategjike të një partneri. Ne përgëzojmë ata partnerë të Ballkanit Perëndimor që kanë arritur tashmë harmonizimin e plotë dhe u bëjmë thirrje atyre që nuk e kanë bërë ende këtë që të ecin në të njëjtat hapa.
9. BE-ja mirëpret kontributet e partnerëve në misionet dhe operacionet e **Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes së BE-së**. BE-ja vazhdon të mbështesë Ballkanin Perëndimor në trajtimin e kërcënimeve kibernetike dhe kërcënimeve të tjera hibride, manipulimit dhe ndërhyrjeve të huaja në informacion, si dhe për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit për të zhvilluar qëndrueshmëri, duke përfshirë Qendrën e Kapaciteteve Kibernetike të Ballkanit Perëndimor dhe Mburojën Evropiane të Demokracisë.
10. Ne mirëpresim partneritetet e **para të sigurisë dhe mbrojtjes** në Ballkanin Perëndimor dhe nisjen e dialogëve të sigurisë dhe mbrojtjes. Ne mbetemi të përkushtuar për mbështetje të vazhdueshme në kuadër të Instrumentit Evropian të Paqes.
11. BE-ja vazhdon të jetë e përkushtuar në afrimin e partnerëve të Ballkanit Perëndimor me BE-në që në fazën e procesit të zgjerimit. **Integrimi gradual**, i realizuar në mënyrë të kthyeshme dhe të bazuar në merita, është në proces e sipër në disa fusha të politikave, duke

sjellë përfitime paraprake konkrete për qytetarët dhe duke përgatitur terrenin për anëtarësim. Duhet të merren parasysh propozime të mëtejshme për integrimin gradual, në përputhje me harmonizimin përkatës me legjislacionin (acquis) e BE-së. Përparimet në drejtim të integritit ekonomik duhet të ruajnë plotësisht integritetin e tregut të vetëm të BE-së dhe kushtet e barabarta.

12. Ne mirëpresim progresin në **integrimin gradual të partnerëve të Ballkanit Perëndimor në Tregun e Vetëm të BE-së**, duke përfshirë në:

- vënien në zbatim të **nismave të Rrugës së Shpejtë të Tregut të Vetëm**, zgjerimin e **korsive të gjelbra** midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe financimin e modernizimit dhe **harmonizimit të kalimeve kufitare**;
- aderimin e suksesshëm të disa partnerëve në **Zonën e Vetme të Pagesave në Euro (SEPA)** me të tjerë në rrugën e duhur për t'u bashkuar, duke ulur ndjeshëm kostot e transaksioneve bankare;
- bashkimin në **nismat dixhitale** ose kopjimin e tyre, të tilla si Qendrat e Inovacionit Dixhital, WiFi4WB dhe Portofoli i Identitetit Dixhital të BE-së;
- **reduktimin e kostove të roaming-ut për internetin** midis BE-së dhe partnerëve të Ballkanit Perëndimor që nga 1 tetori 2023, duke konfirmuar angazhimin dhe procesin e shtrirjes së zonës së BE-së **“Roam like at Home”** në Ballkanin Perëndimor, duke u lejuar qytetarëve të telefonojnë, dërgojnë mesazhe dhe përdorin internetin celular kudo në BE dhe rajon pa kosto shtesë.

13. **Plani i Rritjes do të përshpejtojë konvergjencën socio-ekonomike ndërmjet Ballkanit Perëndimor dhe BE-së, me kusht që partnerët të zbatojnë reformat e lidhura me BE-në. Plani i Rritjes ka potencialin të përshpejtojë rritjen ekonomike në rajon gjatë dekadës së ardhshme duke siguruar deri në 6 miliardë euro për reforma dhe investime. Kjo vlerë i shtohet 29 miliardë eurove që po shpërndahen përmes Planit Ekonomik dhe të Investimeve. BE-ja bën thirrje që të shfrytëzohen maksimalisht mundësitë e jashtëzakonshme që ofron Plani i Rritjes përmes zbatimit në kohë të reformave.**

14. BE-ja thekson se **Tregu i Përbashkët Rajonal** shërben si një katalizator për integrim më të thellë dhe një hap drejt Tregut të Vetëm të BE-së. BE-ja u bën thirrje partnerëve të Ballkanit Perëndimor që të angazhohen plotësisht në bashkëpunimin konstruktiv për ta bërë atë realitet dhe për të zbatuar marrëveshjet e lidhura.

15. BE-ja mirëpret dhe do të vazhdojë të mbështesë forcimin e lidhjeve, duke përfshirë në fushën e energjisë, transportit dhe atë dixhitale, brenda rajonit dhe me BE-në. BE-ja vazhdon të mbështesë **përpjekjet e vazhdueshme për të diversifikuar burimet dhe rrugët e furnizimit me energji**. Kjo do të rrisë sigurinë tonë energjetike dhe do të reduktojë varësitë. BE-ja do të vazhdojë të kontribuojë në tranzicionin energjetik në Ballkanin Perëndimor.
16. **Menaxhimi i emigracionit** mbetet një sfidë dhe përgjegjësi e përbashkët kryesore. Ndërsa është bërë përparim, nevojitet veprim i mëtejshëm nga partnerët e Ballkanit Perëndimor për të përafruar plotësisht politikën e tyre të vizave me BE-në, për të luftuar kontrabandimin e emigrantëve dhe trafikimin e qenieve njerëzore, si dhe për të forcuar më tej sistemet e menaxhimit të kufijve, azilit dhe pritjes dhe kthimet në vendet e origjinës.
17. Përpjekjet e përbashkëta duhet të vazhdojnë gjithashtu në **luftën kundër korrupsionit, trafikimit të drogës dhe të gjitha formave të krimit të rëndë dhe të organizuar**, si dhe në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në përputhje me Planin e ri të Përbashkët të Veprimit të nënshkruar së fundi, **dhe në kuadër të lançimit të Koalicionit Evropian kundër Drogës (ECAD) për të trajtuar sfidat e lidhura me drogën**.
18. Mungesa e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit vazhdon t'i pengojë të dy partnerët në rrugën e tyre drejt Evropës. Të gjitha marrëveshjet e arritura në dialogun **Beograd-Prishtinë të ndërmjetësuar nga BE-ja** duhet të vihen në zbatim, në veçanti Marrëveshja për Rrugën drejt Normalizimit dhe Shtojca e saj. **Mbështetja në kuadër të Instrumentit për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor kushtëzohet nga angazhimi konstruktiv i partnerëve me progres të matshëm dhe rezultate të prekshme në normalizimin e marrëdhënieve të tyre**.
19. Theksojmë rëndësinë e përpjekjeve të vazhdueshme të ndërsjella në **komunikimin strategjik**, duke përfshirë përfitimet nga zgjerimi dhe integrimi gradual, si dhe nevojën për ndërtimin e besimit, mirëkuptimit dhe konsensusit ndërshoqëror. Ne presim që partnerët tanë të Ballkanit Perëndimor të informojnë publikun e tyre se BE-ja mbetet partneri më i afërt i rajonit, si dhe donatori, investitori dhe partneri tregtar kryesor, si dhe të demonstrojnë angazhimin e tyre ndaj vlerave të BE-së dhe reformave përmes fjalëve dhe veprimeve.
20. Mbetemi në pritje të **samitit të ardhshëm BE-Ballkani Perëndimor në Mal të Zi** në qershor 2026.

21. Përhëndesim pajtimin e partnerëve¹ të Ballkanit Perëndimor me këtë deklaratë.

¹ Serbia nuk është pajtuar me këtë deklaratë.